RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Blerina Huruglica	23.03.2022	04.04.2022	*65/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.03.2022 **OE"SBP Construction" SHPK ,** ka parashtruar ankesë me nr. **65/22** kundër njoftimit mbi anulimin aktivitetit të prokurimit me titull:"**Furnizim me material higjeniko Sanitar**", me nr. të prokurimit: **651-21-9492-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**, lloji i kontratës: **Furnizim,** vlera e parashikuar e kontratës: **156 422,00 €**

Data e njoftimit për kontratë.....08.12.2021.
Hapja e ofertave.....18.01.2022.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së.....01.03.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....07.03.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....10.03.2022.

Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

Dispozitat e shkelura nga AK sipas OE ankuesit:

Neni 1 Qëllimi,

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 38 Kontrata Publike Kornizë

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Neni 62 përfundimi i aktivitetit te prokurimit

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Te pa kenaqur me vendimin e AK-së te dates 10.03.2022 ne lidhje me aktivitetin e prokurimit Furnizim me material higjeniko Sanitar me nr. te prokurimit: 651-21-9492-1-1-1 dhe Nr i brendshëm: GL 65121096 111 ne afatin ligjor konform nenit 109 te LPP-së ushtrojme kete ankese prane OSHP-se:

Për shkak se **AK- KUVENDI KOMUNAL- GJILAN :**

- Aktiviteti i Prokurimit eshte anuluar nga AK KK Gjilan ne kundershtim me dispozitat e LPP-së edhe pse sipas AK-se jemi te pergjegjeshem pasi jemi njoftuar me leter standarde si tenderues i pa suksesshëm.

Sqarojmë ne mënyre te detajuar piken e mësiperme:

AK me daten 08.12.2021 ka publikuar njoftimin per kontrate per kete aktivitet te prokurimit ku ne te njejten dite e ka perpiluar edhe dosjen e tenderit per kontraten publike kornizë-Furnizim me nje operator ekonomik ne kohezgjatje per 36 muaj.

Hapja e tenderit ka qene me 18.01.2022 nepermjet platformes se e-prokurimit ndersa pas me shume se nje muaji me daten 21.02.2022 kemi pranuar leter standarde per sqarim te çmimeve te nesermen e kemi kthyer pergjigjen dhe i kemi ofruar AK-se fakte lidhur me çmimet e ofruara.

AK me daten 01.03.2022 per anulim te aktivitetit te prokurimit, dhe me daten 07.03.2022 kemi parashtruar kerkese per rishqyrtim duke I bere me dije AK-se per shkeljet ligjore te cilat I kane bere per kete aktivitet dhe me date 10.03.2022 Ak na kthen vendimin per refuzim te kerkeses sone per rishqyrtim.

Tani me poshte edhe prane OSHP-se po I paraqesim shkeljet te cilat I ka bere AK lidhur me kete aktivitet te prokurimit ku ne menyre te kunderligjeshme AK e nxjerr vendimin per anulim si me poshte:

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizim me material higjeniko Sanitar

Nr. i Prokurimit:	651	21	9	4	9	2	1	1	1
Nr i brendshëm	GL 651	2	1	0	9	6	1	1	1

Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjilan, anulon[2] aktivitetin e prokurimit në mbështetje të nenit 62 (paragrafi 2.1.1)

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

4. Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

4.1 AK gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit janë të obliguar të marrin masa të nevojshme për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim në mesin e Operatorëve Ekonomik.

4.2 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, AK do të ketë obligimet në vijim:c) të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Data: 01.03.2022

U.D. Udheheqese e Zyres se prokurimit

Shqipe Hoxha :

Siç po shihet nga vendimi i AK-së duke u thirr ne nenin 62 (paragrafi 2.1.1) kemi nje mashtrim te AK-se dhe perzierje e paragrafeve te ligjit me poshte po e vendosim komplet nenin 62 me paragrafe.

Sido qe te jete arsyeja e anulimit te tenderit se :

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Eshte nje keq interpretim i Ligjit te Prokurimit nga ana e AK-se pra pikes 1 te nenit 62 pasi nese thiret AK ne kete nen, do te thote se kemi te bejme me Probleme ligjore per te cilat nuk eshte pergjegjes Operatori Ekonomik por ndonje problem ndermjet ligjeve ne fuqi p.sh. ligjit te prokurimit dhe ligjit te ambientit ku nuk ka mundesi te ekzekutohet kontrata apo ne te kaluaren nese AK ne njoftimin per kontrate vendos kerkesa tjera e ne dosje te tenderit kerkesa e specifika tjera si shembull mund ta marrim vendimin e OSHP- së PSH 77/17.

Sa per sqarim me te detajuar me poshte po e vendosim komplet nenin 62 te LPP-së :

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Gjithashtu po e vendosim edhe nenin 44.5 dhe 44.6 te RrUOPP-së ku percakton se kur duhet te anulohet nje aktivitet i prokurimit pas hapjes se tenderit.

44.5 Procedura e prokurimit ***pas hapjes së ofertave*** **duhet** të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

(i) asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

(iii) numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE - është më pak se 3;
(iv) nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(v) numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
(vi) nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(vii) asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
(viii) nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
(ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
(x) nëse AK gjate përgaditjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
(xi) nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

44.6 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme:

(i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Nese i shiqojme me kujdes te gjitha pikat e LPP-se dhe RrUOPP-se e vërejmë se asnjera nga to nuk eshte plotesuar per tu anuluar ky aktivitet i prokurimit.

AK na dergon leter standarde si tenderues i pa suksesesheshem ndersa ne anen tjeter e anulon sepse sipas AK-se kemi çmime me te larta se çmimet e tregut pra AK nuk na ka shpall si operator i eliminuar pasi që AK e ka pranuar se i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e tyre te vendosura ne NJK dhe DT, edhe pse çmimet e ofruara nga ana jone jane çmime te tregut me nje perqindje te vogel te fitimit (10%) per kompanine tone.

Në përgjigjen tonë lidhur me letrën standarde për sqarim te tenderit te dates 22.02.2022 ne Menyre te detajuar i kemi sqaruar AK-se per çmimet dhe komplet oferten tone te dorezuar, pra ne kete pergjigje i kemi bashkangjitur

edhe fotot e produkteve me çmime neper markete te ndryshme si dhe i kemi ofruar shpenzimet te cilat krijohen gjat ekzekutimit te kontrates.

AK pasi qe na ka shpallur te pergjegjeshem, pasi qe oferta jone eshte edhe brenda planifikimit te Buxhetit te AK-se, AK ne asnje menyre nuk ka mundurt ta anuloj proceduren duke u thirrur ne nenin 62 te LPP-së.

AK ne vendimin per refuzim te kerkeses per rishqyrtim nuk ka dhene kurrfare arsyetimi se pse e kane refuzuar kerkesen tone por as kurrfar arsyetimi per anulimin e ketij aktiviteti te prokurimit.

AK vet bie ne kundershtim me vetvehten kur ne nje ane na shpall te pergjegjeshem dhe na njofton me leter standarde per tenderues te pa sukseseshem e ne anen tjeter e anulon tenderin, kjo po ndodhe per here te pare ne histori te prokurimit ne Republiken e Kosoves.

Siç shihet me larte asnje pikë nenit 62 te LPP-se nuk eshte plotesuar per anulimin e ketij aktiviteti te prokurimit, andaj ky aktivitet duhet te rivleresohet prap nga AK dhe te shpallemi fitues pasi qe kemi kemi dorezuar tender te pergjegjeshem dhe me çmimin me te ulët.

Pra siç shihet me lartë ky aktivitet i prokurimit eshte anuluar ne kundershtim me dispozutat e LPP-së konkretisht ne kundershtim me nenin 62 te LPP-se ku asnje pike e ketij neni nuk plotesohet per te perfunduar ky aktivitet i Prokurimit.

Sa per ilustrim mund te marrim shembull te njejte edhe vendimin e OSHP-se PSH 414/19, vetem dallimi ketu eshte se per arsye te njejte OE eshte eliminuar pastaj eshte anuluar tenderi kurse ne rastin tone neve jemi shpallur te pergjegjeshem e pastaj eshte anuluar tenderi.

Zyrtari pergjegjes i prokurimit i AK ne kete rast çështjen nga procedura administrative e ka kaluar ne procedure penale pasi qe neve e kemi paralajmeruar AK-ne edhe ne pergjigjen tone kur kane kerkuar sqarime te çmimeve, se kemi patur informata me heret qe ne pamundesi per ta shpallur fitues operatorin tjeter pasi qe eshte i pa pergjegjeshem ne menyre te kunderligjeshme AK e anulon tenderin vetem te mos na shpall neve fitues.

Me kete veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: *vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.*

Gjithashtu shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : *Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Si dhe ne piken 2 thuhet:

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Gjithashtu shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 59 te LPP-së ku ne piken 4 thuhet se :
Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Pra neve kemi dorezuar tender i cili eshte ne perputhshmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin per kontrate dhe dosje te tenderit.

AK nuk e ka cekur asnje nen te LPP-se qe eshte shkelur lidhur me kete aktivitet te prokurimit.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne ketë aktivitet te Prokurimit andaj, kerkojmë nga AK qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat e ligjit te prokurimit publik gjithashtu ti respektoj kërkesat e veta te cilat vet i ka vendosur ne njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit dhe te nxjerr;

VENDIM

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik **SBP CONSTRUCTION SH.P.K.** Lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me material higjeniko Sanitar** me numer te prokurimit 651-21-9492-1- 1-1 dhe me numer te brendeshem GL 651 21 096111 te iniciuar nga **AK- KUVENDIKOMUNAL- GJILAN**

II. **ANULOHET** njoftimi Mbi Vendimin për Anulimin të aktivitetit të prokurimit: Furnizim me material higjeniko Sanitar me numer te prokurimit 651-21-9492-1-1-1 dhe me numer te brendeshem GL 651 21 096 111 te iniciuar nga AK- KUVENDI KOMUNAL- GJILAN dhe lënda kthehet ne Rivlerësim.

Pas rivlerësimit AK-në ta shpërblej me kontrate Operatorin SBP CONSTRUCTION SH.P.K. Pasi që të vetmit kemi dorëzuar tender te përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, konform të gjitha kërkesave te AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit-kopje

Kërkesa 2. Regjistrimi i TVSH;

Kërkesa 3. Regjistrimi i Numrit Fiskal

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktuese si qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik gjate 3 vitet e fundit ka qen jo me pak se 200.000,00 euro.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratatë ngjajshme në 3 vitet e fundit(duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Në një vlere prej jo me pak se 200.000,00 euro.

Kërkesa 2. Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme a) Një (1) Master ose Bachellor i diplomuar i Ekonomis e me pes vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit), i cili duhet të jetë Menaxher për këtë kontratë.

Kërkesa 3. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. a) 2 (dy) Pikapa

Kërkesa 4.Depo në Komunen e Gjilanin min 60 m2 Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen me Çertifikat prone

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

Dëshmia 1. Certifikata e regjistrimit te biznesit – kopje
Dëshmia 2. Certifikata e TVSH-së-kopje
Dëshmia 3. Certifikata e numrit fiskal-kopje

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Dëshmia 1. Deklaratat Tatimore Vjetore te Tatimit ne te Ardhurave ose Korporata ose Pasqyrat Financiare te Audituara nga Auditori i Licencuar.

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Dëshmia 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat dhe pranimin teknik ose certifikatat për kryerje te punëve.

Dëshmia 2. Për Menaxherin e Kontratës OE duhet te dorëzojnë CV-te, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.

Dëshmia 3. Duhet të ofrohet një listë e pajisjeve sipas Aneksit 1 te Dosjes se Tenderit, te jete e noterizuar nga noteri, verifikimit nga noteri te behet në terren me qellim te verifikimit, ku kjo liste e pajisjeve, duhet te dorzohet në origjinal. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen, marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët, duhet te jete e noterizuar dhe nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe duhet ti referohet aktivitetit ne fjale.

Dëshmia 4.Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët, duhet te jete e noterizuar dhe nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe duhet ti referohet aktivitetit ne fjale.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Gjatë hapjes së ofertave kanë aplikuar 2(dy) Operator Ekonomik në kopje elektronike

Komisioni i vlersimit gjatë egzaminimit dhe vleresimit të ofertave ka konstatuar se OE "Eurotec" Sh.p.k në përshkrimi e cmimeve në ofertën e tij nuk e ka sjellur përshkrimi e cmimeve të kompletuar sipas përshkrimi të cmimit të ngakuar në E-prokurimit nga Ak , andaj sipas LPP dhe Udhzuesit të Prokurimit oferta juaj eliminohet.

Ndërsa OE "Grupi i Operatorve Ekonomik SBP CONSTRUCTION SH.P.K DHE CENTRAT GROPU COMPANY SH.P.K, Komisioni vlersuese gjatë egzaminimit të ofertes ka konstatuar që oferta juaj është e përgjegjëshme në bazë të Dosjes të Tenderit dhe Njoftimit për Kontrat i plotëson Kushtet Administrative, por në Përshkrimin e Cmimeve në disa pozicione kemi vrejtur Cmime të larta në krahasim me cmimin e tregut dhe i kemi kërkuar sqarim OE dhe mbrenda afatit 2 diteshe na është përgjigjur dhe eshte aryetuar qe ne baze te rritjeve te cmimeve te tregut dhe shpenzimeve tjera (depo, puntoret, transporti etj) dhe ka ofertuar me cmimin totale.

Komisioni gjate vlersimit ka verejtur se ne Pershkrimin e cmimeve te perpiluar nga Njesia Kerkuese ne disa pozicione nuk eshte e definuar sakt (cop, liter, komplet) e disa artikujve neper pozicione te caktuar.

Komisioni i vlersuese deklaron qe gjate vlersimit te ofertave ka vrejtur qe disa mangesi te cekura me larte. Pershkrimin e cmimeve te perpiluar nga Njesia Kerkuese ne disa pozicione nuk eshte e definuar sakt (cop, liter, komplet) e disa artikujve neper pozicione te caktuar, si dhe ne disa pozicione jane verejtur disa qmime te larta nga OP**. Ku ne si komision nuk mund te marrim nje vendim per dhenje apo anulim te tenderit pasi qe nuk kemi njohuri profesionale**.

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE

Sqarim hyrës:

Aktiviteti i prokurimit me titull:"**Furnizim me material higjeniko Sanitar**", me nr. të prokurimit: **651-21-9492-1-1-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**, ka filluar me njoftimin për kontratë me datë 08.12.2021, hapja e ofertave është bërë me datë 18.01.2022, si dhe vendimin AK e publikon me datë 01.03.2022.

Autoriteti Kontraktues në vendimin e publikuar ka anuluar aktivitetin me arsyetimin:

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: Furnizim me material higjeniko Sanitar

Nr. i Prokurimit:	651	21	9	4	9	2	1	1	1
Nr i brendshëm	GL 651	2	1	0	9	6	1	1	1

Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjilan, anulon[2] aktivitetin e prokurimit në mbështetje të nenit 62 (paragrafl 2.1.1)

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit

Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

4. Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

4.1 AK gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit janë të obliguar të marrin masa të nevojshme për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminim në mesin e Operatorëve Ekonomik.

4.2 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, AK do të ketë obligimet në vijim:c) të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Data: 01.03.2022

U.D. Udheheqese e Zyres se prokurimit

Shqipe Hoxha :

Kurse, OE ankuesin e shpallë të pasuksesshëm:

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm [1]

01.03.2022

Komuna e Gjilanit – Departamenti i Prokurimit

Grup i Operatorëve Ekonomik SBP CONSTRUCTION SH.P.K.; Central Group Company SH.P.K.

Nr. i Prokurimit:	**Gl 651**	**21**	**0**	**9**	**6**	**1**	**1**	**1**

Titulli: "Furnizim me material higjeniko sanitar"

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP"

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase cmimi i ofertuar ne oferten tuaj nuk eshte ne perputhje me cmimin e tregut .

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*
Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

[1] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve që i kanë plotësuar të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktues, të paraqitura në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit, por të cilëve nuk u është dhënë kontrata, ngase tenderët e tyre nuk qenë nga më të mirët sipas kriterit për dhënien e kontratës.*

1

Tutje, OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, me datë 16.03.2022 ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK ka bërë shkelje të neneve: 1,6,7,38,59,62 të LPP-së, për faktin se nuk ka trajtuar ofertat në mënyrë të drejtë, duke anuluar aktivitetin e prokurimit jashtëligjshëm.

Për këto pretendime OE ankuesi ka ceke edhe dy landë precedente, vendime të mëparshme nga OSHP PSH.nr 77/17 dhe PSH.nr 414/19

Gjithashtu OE ankues sqaron se, AK ka kërkuar sqarim lidhur me çmimet e ofruara në ofertë, përderisa OE ankues ju është përgjigjur ne afat kohor duke i sqaruar të gjitha çmimet po ashtu dhe duke i dëshmuar edhe rrjedhën e çmimeve të tregut.

Përgjigje në pretendimin ankimor:

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit, shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, OE ankuesi në ofertë ka të bashkangjitur paramasën me cmimet sipas kërkesës së AK-së.

Sa i përket arsyes së Autoritetit Kontraktues lidhur me deklarimin në raportin e vlerësimit se nuk kanë parashikuar paramasën, konsideroj se ky arsyetim nuk mund të qëndojë për faktin se AK gjithashtu ka dhënë edhe sqarime/përgjigje operatorëve të interesuar për ofertim lidhur me njësine:

	2.-Artikulli me nr rendor II- " Detergjent merix 1/3 ose ekuivalent lkg" njesia Cope. Qmimi a duhet te llogaritet per kilogram apo per cope 3 kg ?		2. Artikulli me nr. Rendor 11: DETERGJENT MERIX 1/3 OSE EKUIVALENT 1KG – kerkohet qe qmimi te ipet per 1 kg
	3-Artikulli me nr rendor 13-" Thas mbeturinave 1201a 10/1 " njesia Cope. Qmimi a duhet te llogaritetper I cope apo per IO cope role ?		3. Artikulli me nr. Rendor 13: THAS MBETURINAVE 120L 10/1 – kerkohet qe qmimi te ipet per 1 komplet qe permban 10 copa
	4.-Artikulli me nr rendor 40- "Kalaqe (paket-l()() pal) " njesia Cope. Qmimi a duhet te llogaritet per 100 pale apo per/ cope sepsefurni:imi ne treg eshte per nje cope ?		4. Artikulli me nr. Rendor 40: KALAQE(paket 100-PaL) – kerkohet qe qmimi te ipet per 1 paket qe permban 100 pale kalaqe

Përderisa, sa i përket arsyes së AK-së në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim mund të sqaroj se, meqenëse ky aktivitet i prokurimit është kontratë kornizë tri vjeqare me një Operator Ekonomik, me kriter-cmimi më ulët i peshuar, atëherë nga këto parashikime të bëra nga AK konsideroj se edhe Operatorët Ekonomik mund

të rrezikohen, pasi që trendi i cmimeve është në rritje aktualishtë, dhe se për momentin nuk ka parashikime zyrtare se mund të ketë rënie të tyre, andaj si e tillë ky arsyetim vlerësoj se nuk mund të jetë i qëndrueshëm.

Pretendimi 2.
AK- ne baze te letrës standarde Kërkesë për sqarim e tenderit – Përgjigja e OE nuk është bindëse për AK nga OE , sepse AK nuk mund të paguaj çmimet ne vitin 2022 për çmimet e ofruar për vitin 2023 dhe 2024

Andaj, bazuar në të gjitha që u cekën më lartë AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet e juaja ankimore.

Tutje, sa i përket arsyes së AK-së në njoftimin në letrën standarde, lidhur me nenin 62 par.2.1.1 të cekur, konsideroj se nuk qëndron, për faktin se nuk ka ndonjë shkelje të ligjit që kërkon anulimin, por AK aktivitetin e prokurimit e ka vazhduar duke i hapur ofertat, dhe si e tillë anulimi i aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave nuk përkon me nenin 62 të LPP-së si dhe nenit 44.5, 44.6 të Rruopp-së dhe si e tillë arsyeja e anulimit konsideroj se nuk është i qëndrueshëm.

Andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Neni 62 i LPP-së citat:

Neni 62
Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Rruopp 44.5 dhe 44.6 citat:

44.5 Procedura e prokurimit **pas hapjes së ofertave duhet të anulohet** për një nga arsyet e mëposhtme:
(i) asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
(iii)numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE -është më pak se 3;
(iv)nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(v) numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
(vi)nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(vii) asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;
(viii) nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
(ix)një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
(x) nëse AK gjate përgaditjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
(xi)nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

44.6 Procedura e prokurimit **pas hapjes së ofertave mund të anulohet** për arsyen e mëposhtme:

(i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Si përfundim, autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave bie ndesh me vendimin përfundimtar të tyre, për faktin se në letrën standarde të njejtit OE ankuesin e shpallin të përgjegjshëm por të pa suksesshëm. Dhe si e tillë AK rekomandohet që aktivitetin e prokurimit në fjalë ta kthej në rivlerësim, duke ekzaminuar, analizuar dhe krahasuar ofertat konform LPP-së dhe Rruopp-së.

Citat 56.14 dhe 56.15 Rruopp:

56.14 Duhet të merren masat e nevojshme që Autoriteti Kontraktues që si pasojë e veprimit apo mos veprimit të tyre, neglizhencës apo mungesës së vullnetit, të mos bien ndesh me dispozitat e Ligjit dhe legjislacionit dytësor të prokurimit publik dhe/ose legjislacionit tjetër ne fuqi si rezultat i parashikimit jo të saktë të sasive indikative, apo për arsye tjera shkaqet e të cilave është dashur të parashikohen me kohë gjatë parashikimit të sasive, autoriteti kontaktues duhet të ndërmarrë masa ligjore ndaj zyrtarit/ve përkatës të cilët kanë përgatitur kërkesat e tilla.

56.15 Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, **kontratat me çmime për njësi**, AK duhet të përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët.
Ne këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Ne këto raste ne hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qellim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi. Shuma e sigurimit të ekzekutimit të kontratës ne këto raste duhet të përcaktohet si shume fikse ndërsa për qëllime të raportimit ne KRPP shënohet vlera e parashikuar e kontratës. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (vetem për riparime dhe mirëmbajtje).

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE "SBP Construction"SHPK të aprovohet si e bazuar, vendimi i AK-së mbi anulimin të anulohet gjerësa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Panelit Shqyrtues - **OSHP**

OE ankues - **OE"SBP Construction" SHPK**